

**VENDIM**  
**Nr.833, datë 30.12.2025**

**PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE E TË KRITEREVE QË  
MUNDËSOJNË ZBATIMIN E PARIMIT TË SHKENCËS SË HAPUR DHE JANË  
NË PËRPUTHJE ME POLITIKAT E ZONËS EVROPIANE TË KËRKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 5, të ligjit nr.109/2024, “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. TË PËRGJITHSHME**

1. Zbatimi i parimit të shkencës së hapur nga institucionet që zhvillojnë kërkim shkencor në Republikën e Shqipërisë realizohet në përputhje me standardet dhe kriteret e parashikuara në këtë vendim, të cilat janë në përputhje me ato të zonës evropiane të kërkimit.

2. Zbatimi i parimit të shkencës së hapur në të gjithë veprimtarinë e kërkimit shkencor synon rritjen e bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe shkëmbimin e informacionit në dobi të shkencës dhe shoqërisë, duke e bërë veprimtarinë e kërkimit shkencor të arritshme dhe transparente për të gjithë.

**II. STANDARDET E SHKENCËS SË HAPUR**

Qasja e hapur në veprimtarinë e kërkimit shkencor gjen zbatim në:

1. Publikimet shkencore, si më poshtë vijon:

a) Institucionet që zhvillojnë kërkim shkencor ofrojnë qasje të hapur në versionet digjitale të botimeve shkencore dhe rezultateve të kërkimit shkencor në rastin kur veprimtaritë e kërkimit shkencor financohen apo bashkëfinancohen me fonde publike.

b) Institucionet që zhvillojnë kërkim shkencor, menjëherë pas publikimit të një punimi shkencor, e bëjnë atë të disponueshëm me akses të hapur, së bashku me të dhënat përkatëse të kërkimit dhe rezultatet e tjera kërkimore. Publikimi bëhet me akses të lirë, të menjëhershëm dhe të pakushtëzuar, sipas fushës së kërkimit shkencor në të cilën kërkuesi kryen hulumtimin.

c) Qasja e hapur zbatohet duke mundësuar:

i. një format digjital, përmbajtja e të cilit mund të lexohet dhe të përpunohet lehtësisht nga kompjuterat ose dorëshkrimi i dorëzuar nga autori për botim, i depozituar në një arkiv digjital të sigurt për botimet shkencore;

ii. akses të menjëhershëm të hapur në botimin shkencor të ruajtur në arkivin digjital të cituar në nënndarjen “i”, të kësaj shkronje;

iii. ngarkimin e publikimeve në një databazë shtetërore të të dhënave.

ç) Modalitetet e ruajtjes së arkivave digjitale të sigurt për botime shkencore janë të njëjta me ato të Zonës Evropiane të Kërkimit si dhe ato ndërkombëtare.

d) Çdo publikim shkencor, fizik dhe digjital, i financuar nga fonde të buxhetit të shtetit, publikohet në gjuhën shqipe dhe në një prej gjuhëve zyrtare të Bashkimit Evropian.

2. Të dhënat e kërkimit dhe rezultatet e tjera të kërkimit në formatin digjital, si më poshtë vijon:

a) Në kushtet e financimit apo të bashkëfinancimit nga fonde publike dhe të aksesit të hapur në botimet shkencore, institucionet që zhvillojnë kërkim shkencor kanë detyrim:

i. të hartojnë dhe të përditësojnë periodikisht një plan për menaxhimin e të dhënave kërkimore (PMDK);

ii. të menaxhojnë të dhënat e kërkimit shkencor dhe rezultatet e tjera të kërkimit shkencor të krijuara në kuadër të një bashkëfinancimi publik, duke ofruar përdorueshmëri kohore afatgjatë në ruajtjen e të dhënave, në përputhje me parimet që bëjnë të dhënat e kërkimit dhe rezultatet e tjera

kërkimore të gjatshme, të aksesueshme, të ndërveprueshme dhe të ripërdorshme;

iii. të mundësojnë një qasje të hapur në të dhënat e kërkimit shkencor dhe rezultatet e tjera të kërkimit shkencor, në përputhje me parimin “e hapur sa është e mundur dhe e mbyllur për atë sa është e nevojshme”. Qasja plotësisht e hapur në të dhënat dhe rezultatet e veprimtarive kërkimore-shkencore kufizohet në rastet e cenimit të pronësisë intelektuale, mbrojtjes së të dhënave personale, të kufizimeve të vendosura në marrëveshjen e grantit apo kufizimeve të tjera të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi.

b) Në çdo rast të dhënat, si autorësia, data e publikimit, data e rishikimit, madhësia e skedarit, imazhet, videot dhe faqet e internetit duhet të jenë me qasje plotësisht të hapur.

c) Financuesit e veprimtarive të kërkimit shkencor dhe institucionet që zhvillojnë kërkim shkencor zbatojnë praktika që janë në përputhje me rekomandimet e Zonës Evropiane të Kërkimit lidhur me dokumentacionin ligjor të detyrueshëm dhe me ruajtjen e të dhënave shkencore në arkiva digjitale të sigurt dhe të koduar.

3. Infrastruktura e kërkimit shkencor, si më poshtë vijon:

a) Infrastruktura e kërkimit shkencor funksionon në përputhje me rekomandimet e Zonës Evropiane të Kërkimit, si dhe vendeve ku parimi i shkencës së hapur është i zbatueshëm.

b) Infrastruktura e hapur e kërkimit shkencor përbëhet nga:

i. qendra të dhënash specifike dhe të përgjithshme për *domain*-in me arkiva digjitale të sigurt;

ii. arkiva digjitale të sigurt të institucioneve që zhvillojnë kërkim shkencor për ruajtjen e aksesit të hapur në të dhënat dhe rezultatet e veprimtarive të kërkimit shkencor;

iii. platforma botuese shkencore me akses të hapur.

c) Institucionet e kërkimit shkencor, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor që përfitojnë infrastrukturë kërkimore-shkencore të financuar apo të bashkëfinancuar me fonde publike, kanë detyrimin të mundësojnë qasjen dhe përdorimin e hapur të databazave kombëtare të kërkimit shkencor.

### III. KRITERET E SHKENCËS SË HAPUR

1. Kriteret e përgjithshme që mundësojnë zbatimin e parimit të shkencës së hapur gjatë veprimtarisë kërkimore-shkencore nga institucionet janë, si më poshtë vijon:

a) Veprimtaria kërkimore-shkencore zhvillohet dhe publikohet në mënyrë transparente, duke mundësuar shqyrtim të hapur, kritikë shkencore dhe riprodhueshmëri të plotë, me qëllim garantimin e saktësisë dhe besueshmërisë së rezultateve të publikuara.

b) Veprimtaria kërkimore-shkencore zhvillohet duke garantuar barazi të plotë në qasje, pjesëmarrje, kontribute dhe përfitime për të gjithë kërkuesit dhe palët e interesuara, duke siguruar mundësi të barabarta dhe duke shmangur çdo formë diskriminimi.

c) Veprimtaria kërkimore-shkencore zhvillohet me përgjegjësi dhe llogaridhënie, duke siguruar që rezultatet e saj të jenë të matshme, të justifikueshme dhe të orientuara drejt ndikimit pozitiv në zhvillimin e shoqërisë.

ç) Veprimtaria kërkimore-shkencore zhvillohet duke siguruar reciprocitet dhe përfshirje të plotë, që garanton rritjen dhe zgjerimin e bashkëpunimit në të gjitha nivelet e veprimtarisë kërkimore-shkencore.

d) Veprimtaria kërkimore-shkencore zhvillohet duke garantuar fleksibilitet, duke nxitur diversitetin në zgjedhjen dhe ndjekjen e rrugëve të ndryshme për realizimin e parimit të shkencës së hapur.

dh) Veprimtaria kërkimore-shkencore zhvillohet duke garantuar qëndrueshmëri përmes sigurimit të praktikave, shërbimeve, infrastrukturave dhe modeleve afatgjata të financimit, të dokumentuara dhe të mbështetura nga politika institucionale dhe kombëtare.

2. Kriteria të veçanta që mundësojnë zbatimin e parimit të shkencës së hapur gjatë veprimtarisë kërkimore-shkencore nga institucionet janë, si më poshtë vijon:

a) Qasja e hapur (*Open Access*) detyron aplikimin e parimeve “FAIR”, ku të dhënat e veprimtarisë kërkimore-shkencore janë të gjatshme, të aksesueshme, të ndërveprueshme dhe të ripërdorshme.

b) Të dhënat e hapura (*Open Data*) detyrojnë publikimin e të dhënave mbi të cilat është realizuar veprimtaria kërkimore-shkencore.

c) Metodologjia e hapur (*OpenMethodology*) detyron publikimin e metodave dhe teknikave që janë përdorur gjatë realizimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore.

ç) Rekomandimi i kolegëve (*OpenPeerReview*) detyron publikimin e rekomandimeve nga kërkues të tjerë kërkimorë-shkencorë.

d) Shkenca qytetare dhe bashkëpunimi (*CollaborationforCitizenScience*) detyron publikimin e subjekteve publike ose private, që kanë kontribut në veprimtarinë kërkimore-shkencore.

dh) Integriteti kërkimor (*ResearchIntegrity*) detyron zbatimin e standardeve më të larta kërkimore-shkencore dhe etike në veprimtarinë kërkimore-shkencore.

e) Vlerësimi rigoroz (*RigorousEvaluation*) cakton metodat e matjes etike, cilësore dhe sasiore të veprimtarisë kërkimore-shkencore, sipas udhëzuesit ndërkombëtar TOP Transparence (*TransparencyandOpennessPromotion – Guideline*).

#### IV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Zbatimi i përcaktimeve të këtij vendimi lidhur me kriteret e shkencës së hapur do të jetë në fuqi deri në aderimin në Bashkimin Evropian, ku në vijim zbatohen përcaktimet e bëra në rregulloren e BE 2021/695 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 28 prill 2021, “Për themelimin e programit *HorizonEurope* – programi kornizë për kërkimin dhe inovacionin, përcaktimin e rregullave për pjesëmarrjen dhe përhapjen, si dhe shfuqizimin e rregulloreve (BE) nr.1290/2013 dhe (BE) nr.1291/2013”.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për kërkimin shkencor, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe institucionet që zhvillojnë kërkim shkencor, të financuara apo të bashkëfinancuara me fonde publike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**